

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI MJEKESOR I TIRANES
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKESORE TEKNIKE

Shputa diabetike:

Trajtimi dhe mundësia e parandalimit të amputimeve madhore

Punim disertacioni

Udheheqes shkencor

Prof dr Isuf Kalo

Autori

Harieta Saracini

PERMBAJTJA

1. Shkurtesat.....	4
2. Hyrje.....	5
3.Sëmundja e sheqerit- Diabetes mellitus.....	5
3.1.Etiologjia dhe patogjeneza.....	6
3.2.Simptomatologjia dhe diagnostikimi.....	8
3.3. Komplikimet.....	9
3.3.1. Komplikimet akute.....	9
3.3.2. Komplikimet kronike.....	9
3.3.2.1.Dëmtimet e zemrës dhe enëve të gjakut.....	10
3.3.2.2. Dëmtimet e nervave.....	10
3.3.2.3. Dëmtimet e veshkave.....	10
3.3.2.4. Dëmtimet e syve.....	11
3.3.2.5. Dëmtimet e shputës.....	11
3.3.2.6. Infeksionet e lëkurës dhe indeve të buta.....	11
4. Shputa diabetike.....	12
5.1. Hyrje.....	12
5.2. Etiologjia e dhe patogjeneza.....	12
5.3. Ulcera diabetike.....	13
5.3.1. Neuropatia.....	13
5.3.2. Mikrobiologjia.....	16

5.3.3. Roli i kallusit.....	18
5.3.4. Arthropatia Charcot.....	19
5.3.5. Semundjet vaskulare.....	20
5.3.6. Kepucet joadekuate.....	22
5.4. Klasifikimi.....	23
5.5. Simptomatologjia.....	25
5.6. Evaluimi diagnostik.....	29
5.6. Parandalimi dhe trajtimi i sëmundjes.....	32
6. Qëllimi i punimit.....	37
7. Materiali dhe metodat.....	39
8. Rezultatet.....	42
9. Diskutimi.....	76
10. Propozimet e masave.....	83
11. Abstrakti.....	87
12. Bibliografia.....	90

SHKURTESAT

DM.....	Diabetes Mellitus
SHD.....	Shputa diabetike
UD.....	Ulcera diabetike
MB.....	Mikrobiologjia
SPV.....	Sëmundjet periferike vaskulare
SPA.....	Sëmundjet periferike arteriale
NP.....	Neuropatia periferike
ANP.....	Angioneuropatia
ECHO.....	Ultrazëri
CT.....	Tomografi e kompjuterizuar
RTG.....	Imazhe rentgenologjike
MRI.....	Imazhe të rezonancës magnetike
SE.....	Sedimentacion i eritrociteve
MO.....	Mikroorganizëm
MRSA.....	Staphylococcus aureus methicilin resistant
QKUK.....	Qendra Klinike Universitare e Kosovës

H Y R J E

Sëmundja e sheqerit -Diabetes mellitus bën pjesë në grupin e sëmundjeve kronike e cila në vende ekonomikisht të zhvilluara, por edhe në ato në zhvillim e sipër,zë vend të rëndësishëm si për nga shpeshtësia e paraqitjes ashtu edhe nga komplikimet e edhe vdekshmëria. Ajo tani nuk është vetëm problem individual i të sëmurit nga diabeti por ka përmasa të sëmundjes masive. Shënimet e para për sëmundjen e sheqerit datojnë qysh nga viti 1500 p.e.s. në dorëshkrimet e Egjiptasve të vjetër, te cilët përshkruan "zbrazje shumë të madhe të urinës". Shëruesit indiane në të njëjtën kohë e vlerësuan sëmundjen si urinë nga mjalta duke vënë në dukje se urina tërhiqte milingonat (21,22). Përshkrimi i plotë klinik është bërë nga mjekët Aretaeus dhe Cappadocia. Ata bënë përpjekje për ta shëruar sëmundjen ,por nuk i dhanë prognozë të mirë duke thënë se "jeta me diabet është e shkurtër, e neveritshme dhe e dhembshme".(23). Mering dhe Minkowski, më 1889 zbuluan se pankreasi i hequr te qejt eksperimental ka sjellë deri te zbulimi i shenjave të diabetit e edhe vdekja e tyre.(24). Më 1869 shkencëtari Langerhans identifikoi grupe qelizash të pankreasit që kontrollojnë nivelin e glukozës në trup dhe ato, sipas tij edhe u

emërtuan "ishujt e Langerhansit". Në vitin 1923, një kompani farmaceutike EliLilly në Universitetin e Torontos, filloi prodhimin e insulinës në masë të madhe me c'rast u trajtuan 25000 pacientë. Për këtë Banting dhe John MacLeod,udhëheqësit e kompanisë morrën cmimin Nobel për Mjekësi. Prodhimi i insulinës u përhap shumë shpejt nëpër botë, ndërsa Banting u nderua edhe me faktin se ditëlindja e tij, 14 nëntori, u caktua si dita botërore e Diabetit.

1.2. ETIOLOGJIA DHE PATOGJENEZA.-Sëmundja e sheqerit është sindromë e cila paraqitet në këto forma klinike:Diabeti tip I/që paraqitet kryesisht te fëmijët dhe personat e rinj, rënia ose mungesa e plotë e prodhimit të insulinës dhe diabeti tip II qe karakterizohet me prodhimin e pamjaftueshëm ose rezistencën e indeve trupore ndaj veprimit të insulinës. Etiologjia e diabetit të tipit I mund të jetë: autoimune ose idiopatike, ndërsa e tipit II rezistenca e insulinës dhe defekti në aktivitetin sekretor të saj. Poashtu si faktorë etologjik janë edhe defektet gjenetike të funksionit të qelizave, sëmundjet e pankreasit ekzokrin (Pankreatiti, trauma, neoplazmat etj), endokrinopatitë (sëmundja e Cushingut, Pheochromocytoma, Aldosteronoma etj), infeksionet (rubeolla kongjenitale, infeksionet me citomegalovirus), diabeti gestagonal, diabeti për shkak të përdorimit të barërave dhe/ose drogave. (27).

Tipi I i diabetit haset te rreth 15% të të gjithë sëmurëve nga diabeti. Për shkak të mosprodhimit të insulinës, jeta e këtyre pacientëve detyrimisht është e varur nga insulina të cilin pacientët janë të detyruar ta marrin gjatë gjithë jetës cdo ditë. Prandaj ky tip diabeti quhet edhe diabeti i varur nga insulina. Tipi II i diabetit është shumë më i shpeshtë dhe haset deri në 85% të të sëmurëve nga diabeti. Pankreasi i këtyre të sëmurëve prodhon insulinë por jo në kohë të duhur dhe sasi të duhur. Për dallim nga i pari, ky lloj i diabetit shfaqet zakonisht pas moshës 40 vjeqare, përparon shumë ngadalë e mund të qëndrojë i heshtur me vite deri sa të diagnostikohet. Pavarësisht se këto dy forma duken fare të ndryshme, ato të dyja prapëseprapë përfaqësojnë të njejtën sëmundje. Pasojat dhe rreziqet nga këto të dyja zhvillohen njejtë, me të njejtat veqori dhe të njejtat komplikacione.(26). Insulina si hormon që e prodhon dhe e tajon pankreasi ndihmon glukozën që të hyjë në qelizat e indeve ku edhe transformohet gjatë proceseve metabolike. Kjo e ndihmon prodhimin dhe lirimimin e energjisë së nevojshme për aktivitet të përditshëm. Gjatë këtij aktiviteti insulina e zvogëlon sasinë e glukozës në gjak, nëse ajo rritet mbi vlera normale. Eshtë konstatuar se insulina ka ndikim të rëndësishëm në metabolizmin e yndyrnave, proteinave, kripërave dhe mineraleve. Tajitja e pamjaftueshme e

insulinës rezulton në ngritjen e nivelit të glukozës në gjak dhe manifestimin e shenjave të diabetit.(11).

SIMPTOMATOLOGJIA DHE DIAGNOSTIKIMI.- Simptomat kryesore të diabetit mund të zhvillohen shumë shpejt, te diabeti i tipit I ose shumë ngadalë (deri edhe me vite) te diabeti i tipit II. Ato janë humbja në peshë, polidipsia (etje e shpeshtë), poliuria (urinimi i shpeshtë) dhe polifagia (uritje e shpeshtë). Poashtu si simptomatologji jospecifike duhet cekur edhe lodhjen, dhimbjen e shpeshtë të kokës, crregullimet e shikimit etj. Me dekada diagnostikimi është bazuar në kriteret e glukozës në plazëm. Vlerat optimale të sheqerit në gjak janë 4.5- 6.6 mmol/l ,si dhe në vlerësimin dyorësh të tolerancës së 75gr glukozë orale (OGTT) (34). Tregues i mirë i sheqerit në gjak është edhe hemoglobina e glukolizuar apo lidhja e hemoglobinës me glukozë. Pasi që ajo lidhje është e vazhdueshme gjatë gjithë jetës së eritrocitit, edhe rezultati i saj tregon se deri në çfarë mase eritrociti gjendet në një mes me glikemi të rritur dhe atë aq sa edhe jeton ai eritrocit (deri në 3 muaj). Te personat me diabet mirë të kontrolluar kjo vlerë e HbA1C është lehtë mbi vlerën referente për popullatën e shëndoshë. Megjithë testimeve laboratorike,rezultatet duhet të përsëriten disa here në mënyrë që të shmangen gabimet laboratorike bile edhe te rastet e paraqitjes së shenjave klasike të hiperglikemisë apo edhe të krizës

hiperglikemike. Pasi që diagnostikohet testimet duhen bërë së paku një herë në tre muaj.

KOMPLIKIMET.- Janë komplikimet e shumta të cilat i jep kjo sëmundje ato që e bëjnë diabetin problem të madh për shoqërinë. Ato paraqiten në formën e tyre akute si ketoacidoza dhe koma diabetike hiperglikemike dhe koma hipoglikemike.

Komplikimet kronike konsistojnë në grup heterogjen të crregullimeve klinike. Komplikimet kronike janë afatgjata dhe zhvillohen gradualisht dhe nuk mund të parashikohet zhvillimi i ndonjërit prej këtyre komplikimeve. Ato pos që mund të kenë si pasojë paaftësinë e organizmit në forma të ndryshme ato mund të sjellin edhe rrezik për jetë duke qenë se tipi II i diabetit fillimisht mund të mos manifestohet me shenja klinike të vërejtshme dhe i sëmuri të ndjehet mirë dhe të injoron pengesat e vogla eventuale. Komplikimet potenciale të diabetit janë:

Sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut: Diabeti në mënyrë dramatike rrit rrezikun nga sëmundjet e enëve të gjakut dhe të zemrës, duke përfshirë sëmundjet koronare të arterieve, ngushtimin apo mbylljen e arterieve dhe tensionin arterial të rritur. Sipas Asociacionit Amerikan të Zemrës rreziku nga sëmundjet kardiovaskulare është dy

deri në kater herë më i madh te të sëmurët me diabet se sa te të sëmurët pa diabet.

Dëmtimi i nervave neuropatia : Sasia e shtuar e sheqerit në gjak mund të dëmtojë muret e enëve të vogla të gjakut që ushqejnë nervat, posaqërisht në ekstremitetet e poshtme e që manifestohet me mpirje deri te humbja complete e ndjenjës në to.

Dëmtimi i veshkave nefropatia: Veshka përbëhet prej miliona vazave të imta të gjakut të cilat filtrojnë mbeturinat nga gjaku. Diabeti dëmton këtë sistem delikat të filtrimit. Dëmtimet e rënda mund të çojnë në dështimin e veshkave ose sëmundje të pakthyeshme të veshkave(48) që në fazën e fundit përfundon me dializë apo transplantim të veshkave.

Dëmtimi i syve/ retinopatia: Diabeti dëmton enët e vogla të gjakut të retinës që potencialisht çojnë në verbim. Poashtu diabeti shton rrezikun edhe të konditave serioze të vizusit/ si katarakta dhe glaukoma.

Dëmtimet e shputës- Dëmtimet nervore dhe dëmtimet e vazave periferike të shoqëruara me perfuzionin e dobët të indeve në shputë rrisin rrezikun për ndryshime nekrotike duke filluar nga celuliti, ulceracioni dhe nekroza e të cilat shpesh me infeksione të ndryshme përfundojnë me gangrenë e cila sjell amputimin qoftë të gishtit, shputës apo edhe të krejt ekstremitetit në nivele të ndryshme.

Infeksionet e lëkurës dhe të gojës në trajtën e infeksioneve bakteriale e edhe fungale.

Osteoporoza etj.

SHPUTA DIABETIKE

HYRJE- Crregullimet e shputës, cfarëdo natyrë që janë e shtojnë rrezikshmërinë e të sëmurëve nga diabeti për hospitalizim, amputim e edhe vdekje, prandaj edhe këto gjendje kërkojnë edhe trajtim korrekt

multidisciplinar, por me theks të caktuar te endokrinologu, kirurgu vaskular dhe eventualisht ortopedi, kardiologu dhe reanimatologu. Rrezikshmëria gjatë jetës së diabetikut që ti shfaqet ulcera diabetike në shputë është rreth 15%, gjërsa 60% të ulcerave edhe gjatë prezantimit fillestar janë të inflamuara, e kur ulcera diabetike zhvillohet, një në pesë prej këtyre pacientëve mbarojnë me amputim të ndonjë pjesë të ekstremitetit (2, 28).

ETIOLOGJIA DHE PATOGJENEZA.- Sëmundja manifestohet me infeksion, ulcerë ose gangrenë. Tre faktorë primar ndikojnë në paraqitjen e shputës diabetike dhe komplikimeve të saj: neuropatia, perfuzioni i zvogëluar me gjak dhe zvogëlimi i rezistencës për infeksion (1,2). Poashtu edhe kombinationet e rastit, trauma, deformitetet e shputës e ndihmojnë paraqitjen e infeksionit dhe ulcerës (3). Me interes të veçantë është detektimi i hershëm i këtyre faktorëve të rrezikut.

ULCERA DIABETIKE.- Anatomia e shputës dhe arkitektura e kockave kanë siguruar mbështetje të saktë të peshës trupore në disa pika mbështetëse. Pasi që shputa e diabetikut me kohë e humb formën primare dhe deformohet vjen deri te ndryshimi i lokalizimit të pikave mbështetëse. Këto pika të reja dhe indet e tyre nuk kanë menjëherë aftësi të përshtaten edhe për shkak të forcës së shtypjes mekanike. Prandaj në këto vende vjen deri te trashja e lëkurës dhe atë posaqërisht

në regjionin e thembrave dhe të gishtave I,IV dhe V që janë pikat mbështetëse kryesore. Lëkura e trashur e humb elasticitetin dhe forcohet dhe në ato vende ndodhin plasaritje të cilat thellohen dhe shkaktojnë plagë. Nga sekrecioni i shtuar,qelizat e trashura dhe të vdekura shkatërrohen dhe lënë pas vehtes një hapsirë me fund të skuqur dhe të inflamuar dhe me skaje të cilat e formojnë kufirin e ulcerës.

Ndryshimet të cilat paraqiten në shputë nganjëherë janë aq karakteristike sa që në bazë te tyre mund edhe te konstatohet sëmundja e sheqerit.(8),

NEUROPATIA.-lejon stres të vazhdueshëm në shputë i cili ndodh pa u hetuar nga pacienti e që rezulton në stadet e avansuara me ulqerë në shputë.

Neuropatia te pacientët me shputë diabetike manifestohet në tri forma:

-Neuropatia sensorike.- Humbje e ndjeshmërisë së shputës ndaj dhimbjes, temperaturës dhe shtypjes. Humbja graduale e ndieshmërisë qon në uljen e përceptimit të stimulimit.(53,54). Për këtë arsye lezionet të cilat te njeriu i shëndoshë regjistrohen normalisht, të këta pacientë mund të fshihen deri në paraqitjen e nekrozës. Poashtu reflexi patellar dhe i Achilit është i dobësuar.

-Neuropatia motorike.-shkakton dobësim të muskulaturës kryesisht interoseale që pason me flexion anormal të gishtave, të shputës dhe presion të lartë plantar, posaqërisht në kokën e metatarsëve. Gefen(51) konstaton se ky presion te diabetikët është 4 deri në 8 herë më i madh. Testi më i thjeshtë për diagnostikimin e neuropatisë është testi me 10g monofilament(55).

-Neuropatia e sistemit autonom shkakton vazodilatacion dhe anhidrozë, e cila qon në crregullim të qarkullimit të gjakut dhe perspiracionit të lëkurës.

Identifikimi i ishemisë vaskulare te të sëmurët me diabet është mjaft i vështirë meqë diabeti e maskon isheminë (4). Ishemia e kombinuar me neuropatinë diabetike konsiderohet si rrezik i madh për humbjen e ekstremitetit. Andaj evaluimi komplet i pacientit përfshirë edhe trajtimin lokal agresiv të plagës janë masat më efektive në prevenimin e komplikimeve të shputës diabetike.

Edhe pse shputa diabetike mund të zhvillohet pa praninë e faktorit traumatik më së shpeshti e tëra fillon me një plagë ose prishje të barrierës lëkurore e cila mund të jetë me dimension shumë të vogël dhe shumë sipërfaqore e që pastaj përhapet në strukturat e thella e që potencialisht qon në abscese, celulit, ulcera kronike dhe osteomielit. Në disa studime të fundit kemi të dhëna se edhe përkunder arsimimit

më të lartë të popullatës dhe followup të rregullt, prapseprap numri i të prekurve është mjaft i lartë. Një bashkëveprim edhe jo i plotë i tërë faktorëve të rrezikut mund të shkaktojë plagën e cila në raste përfundon keq.

Humbja e ndjesisë për shkak të neuropatisë është një nga faktorët kyq në paraqitjen e plagës në shputë te diabetikët. Prandaj është e domosdoshme vetkontrolla e vazhdueshme apo edhe e përditshme e shputave së pari nga ana e vet pacientit. Plaga në shputë shpesh shkaktohet edhe nga traumat e përsëritura dhe të vazhdueshme si psh deformitetet e shputës, të mbathurat jo të përshtatshme, e në raste edhe temperaturat e larta të ujit apo nxemseve të cilat pacienti i përdorë për ngrohje të shputave të ftofta. Lëkura e thatë dhe e plasaritur në kombinim me neuropatinë periferike janë portë e mirë hyrëse për mikroorganizmat. Për shkak të proceseve të dëmtuara metabolike dhe karakterit imunologjik të dobësuar të organizmit, një ulcerë shumë shpejt mund të përparojë dhe shërimi i saj të jetë shumë i vështirsuar.

MIKROBIOLOGJIA- Në rastin e kolonizimit të plagës ulceroze me mikroorganizma paraqiten shenjat e inflamacionit të saj deri te aktiviteti purulent i saj. Ndryshimet më të shpeshta janë polimikrobiale e që shkaktohen nga bakteriet cocce gram pozitive aerobe, posaqërisht

staphylococcus. Bacilet aerobe gramnegative më së shpeshti janë kopatogjene ose shoqëruese dhe gjenden te ndryshimet kronike. Plagët te shputa diabetike të cilat nuk kanë shenja të infeksionit mund të trajtohen pa antibiotikë, ndërsa te ato me shenja të infeksionit terapia antimikrobiale është e domosdoshme. Përkundër trajtimit empirik të bazuar në shenjat klinike diagnoza definitive vendoset me mbjelljen e kulturave të indeve të prekura. Staphylococcus aureus është mikroorganizmi që izolohet më shpesh në këto kultura. Duke qenë se ky mikroorganizëm kërkon sistem imunitar të kompromituar, i cili te diabeti është ekzistues dhe përfshin nivel të ulët të antikorpeve, komplementit dhe neutrofileve e që predispozojnë infeksionet stafilokoksike (14). Edhe pse jo të gjitha studimet konstatojnë, ulceracionet e shpeshta dhe rekurente, megjithëse të trajtuara me antibiotikë por jo me rregull janë faktorë rreziku për paraqitjen e MRSA (13). Kolonitë e MRSA janë rezistente nga të gjitha medikamentet duke përfshirë penicilinat dhe cefalosporinat e që i bën ato shumë të vështira për trajtim(51). Zbulimi i patogjenëve duhet të bëhet sa më shpejt që është e mundur,por asesi nuk duhet anashkaluar edhe rezultatet false negative në rastin e trajtimit paraprak me antibiotikë para se të mirren mostrat. (15). Metodat të cilat zbulojnë faktorët infektues sa më shpejtë janë shumë efikase por mund të jenë të pavlerë në rast se

klinicisti dështon në mënyrën e marrjes së materialit, si psh marrja e materialit para pastrimit të plagës, pas debridmentit etj.(16)

Nga bakteriet gram negative që izoloohen janë Enterobakteriet si Escherichia coli, pastaj Proteus, Klebsiella, Enterobacter dhe atë si bakterie predominante. Lloj i këtyre mikroorganizmave që vështirë mbulohet me terapi antibiotike është Pseudomonas Aeruginosa e cila kërkon terapi në shënjestër, specifike dhe shumë të rregullt. Si shkatarë që asesi nuk duhet anashkaluar janë edhe infeksionet me anaerobe. Këto zakonisht paraqiten si pjesë e pandashme e infeksionit polimikrobiale të plaga nekrotike e edhe ajo iskemike. Kërkon trajtim specifik dhe sa më urgjent, sepse në raste mund të komplikohen me insuficiencë renale akute , intoksikim të organizmit e edhe me vdekje.(17).

ROLI I KALLOS TE ULCERA DIABETIKE.- Kallusi është hiperplazion i shtresës corneale (stratum corneum) të lëkurës që vjen si pasojë e shtypjes mekanike ose fërkimit.(30). Meqë kallusi është shumë i shpeshtë në popull, rëndësi të posaqme ka nëse paraqitet te diabetikët. Sipas Sage (30), 82% të sëmurëve tek të cilet paraqitet ulcera diabetike, kanë vuajtur më herët nga kallusi. Klinikisht kallusi duket si një pllakë hiperkeratotike, me dimensione të ndryshme me tendencë të rritjes dhe që kryesisht manifestohet pa dhimbje. Zhvillimi i ulcerës në

regjionin e kallusit shoqërohet me shenja të inflamacionit përreth si eritemë, temperaturë lokale të rritur dhe ajtje. Për shkak të neuropatisë sensorike dhembja mungon edhe në këto raste gjë që mundëson progredimin e zhvillimit të indit destruktiv. Largimi i kallos zvogëlon presionin plantar dhe ul rrezikshmërinë për ulceracion, e me vone edhe komplikime tjera.(47)



Ulcera diabetike

ARTROPATIA CHARCOT.- Eshtë sindromë e të sëmurëve me neuropati ose humbje të sensacioneve që pason me fraktura ose dislokime të kockave dhe nyjeve të shkaktuara nga trauma minimale ose fare pa traumë ose nga metabolizmi i dëmtuar i kockave. Inicialisht fillon me shenjat e inflamacionit, ndërsa më vonë për shkak të fraktuarve të

kockave ose dislokimit të nyjeve paraqitet jostabiliteti i përgjithshëm.

Sindromi progredon në tri faza:

Faza e parë- **akute**: skuqje, ajtje, temperaturë lokale e rritur, të dhënat e hershme rentgenologjike nuk regjistrohen.

Faza e dytë- **subakute** shenjat e para të inflamacionit përkeqësohen. Radiografia tregon shenja fillestare të ndryshimit në kocka

Faza e tretë .- **kronike** kur shenjat e inflamacionit tërhiqen por janë evidente ndryshimet radiologjike në kocka që pasojnë me deformitete.

Poashtu kjo lloj artropatie paraqitet edhe te sifilisi, poliomieliti, alkooloizmi kronike etj. Diagnostikimi mund të zgjasë disa javë deri në muaj sepse në fazat fillestare përpos edemës së indeve të buta, ndryshimet në kocka nuk janë evidente. Trajtimi është konzervativ por me ndihmesë ndër të cilat është splinti protektiv, shkopi për ecje, etj., ose trajtimi kirurgjikal me korrekim të deformiteteve përmes fiksimeve të brendshme, osteotomisë etj.

SEMUNDJET VASKULARE PERIFERIKE.- Përkeqësimin dhe ashpërsinë e sëmundjes e shkakton edhe iskemia e indeve. Perfuzioni i zvogëluar i indeve përvec që ndihmon zhvillimin e infeksionit pengon edhe

depërtimin e antibiotikut të ordinuar në indet e infektuara. Poashtu disfunksioni imunologjik i shkaktuar nga neutrofilet e dëmtuar dhe fagocitoza janë faktorë predispozues për zhvillim të hovshëm të sëmundjes. (11). Crregullimi i punës së zemrës dhe mekanizmat e crregulluar autorregullatorë të mikroqarkullimit zvoglojnë rrjedhen e gjakut dhe automatikisht edhe mundësinë e shërimit. Sëmundjet akute vaskulare zënë rol të rëndësishëm në zhvillimin e shputës diabetike. Janë një nga faktorët kyq të rrezikut për amputime të ekstremitetit posaqërisht kur kombinohet edhe me faktorët tjerë si neuropatia dhe faktori infekcioz.(32). Skriningu fillestar përfshin historinë e klaudikacioneve si dhe fillimisht inspektionin e shputës dhe palpimin e pulsacioneve periferike, atë në arterien dorsalis pedis dhe atë tibialis posterior. Për shkak të prevalencës së theksuar të SVP dhe faktit se ajo mund të qëndrojë për një kohë asimptomatike, sygjerohet që kontrollimi i pulseve dhe Echo Doppleri i enëve të gjakut të bëhet të pacientët mbi 50 vjeqar, e poashtu edhe te pacientët nën 50 vjeqar por me faktorë prezent të rrezikut për SVP sic janë hipertensioni arterial, hiperlipidemia, pirja e duhanit, diabeti i diagnostikuar mbi 5 vjet(60). Rezultatet pozitive referohen për vlerësim të matutjeshëm të sistemit Vaskular në ekstremitetet e poshtme (35).

Si mekanizëm ndihmës për patogjenezën e shputës diabetike janë edhe *këpucet joadekuate*. Mospërputhja në madhësi në mes të shputës dhe këpucës te pacientet diabetik prishin biomekanizmin e shputës dhe kyqit të saj. Këpucët e ngushta shkaktojnë presion të vazhdueshëm, më shpesh në sipërfaqen mediale ose laterale të shputës. Përkundër këtyre, te këpucët e gjera, si pasojë e rrëshqitjes dhe fërkimit te thembrës në këpucë paraqiten ulceracionet. Studime të shumta në 20 vjetët e fundit psh nga Reddy et al.1989, Barnes et al.2000, Fan et al.2006, rezultuan me të dhëna se rreth gati 1/3 e pacientëve diabetik me komplikime në shputë më heret kishin mbathur këpucë të papërshtatashme.

Klasifikimi.-Janë bërë klasifikime të shumta të lezioneve të shputës diabetike por sot më së shumti shfrytëzohet ai sipas Brodsky i përpiluar në vitin 1999 (5).

0	Shputa jo e rrezikuar pa ulceracione	Edukimi shëndetësor i pacientit, mbathja komode, regjimi higjieno dietetic
1	Ulceracioni sipërfaqësor	Kontrollë e rregulltë mjekësore, mbathje e posaçme, përcjellje e rregulltë e gjendjes dhe strisho me antibiogram
2	Ulceracioni i thellë me tendina të ekspozuara	Debridman kirurgjik, përkujdesje e rregulltë e plagës, antibiotikë specifik (antibiogram)
	Ulceracioni ekstenziv ose absces	Debridman ose amputim parcial, antibiotikë specifik (antibiogram)

Klasifikimi i lezioneve të shputës diabetike sipas thellësisë dhe mënyra e trajtimit Brodsky (St. Louis 1999) (5).

A	pa iskemi	
B	iskemi pa gangrenë	testim vaskular joinvaziv, përcjellje e gjendjes vaskulare
C	gangrenë parciale	intervenim i planifikuar vascular
D	gangrenë complete e shputës	amputim i lartë i ekstremitetit

Klasifikimi i lezioneve të shputës diabetike sipas furnizimit me gjak dhe mënyra e trajtimit Brodsky (St. Louis 1999) (5).

Ky sistem i klasifikimit i ndan lezionet e shputës diabetike në bazë të thellësisë së ulqerës dhe furnizimit me gjak. Tretmani i preferuar e reflekton edhe shkallën e rrezikut për secilën kategori (5).

SIMPTOMATOLOGJIA.- Shumë grupe punuese autoritative janë marrë me vendosjen e një definicioni të saktë për shputën diabetike. Por gati se të gjithë janë pajtuar që prezenca e më shumë se dy

shenjave e përcakton sëmundjen. Skuqja, temperatura lokale e rritur, dhimbja-në raste, ajtja, induracioni janë shenjat e para të infeksionit. Për shkak të angioneuropatisë dhembja shumë shpesh mund të mungojë. Simptomat sistemike përfshijnë ethe, dridhje, anoreksi, crregullim hemodinamik (tahikardi, hipotension) , crregullim të proceseve metabolike (acidozë, hipovolemi e deri te insuficienca akute e veshkëve), SE i rritur dhe leukocitoze (49). Nuk janë të rralla edhe rastet kur këto shenja mungojnë. Ato janë gjithsesi të pranishme te pacientët me infeksion të rëndë me përfshirje të gjërë të indeve nga prania e bakterieve të ndryshme dhe shumë virulente. Sëmundja persiston me sekrecion të shtuar lokal, me presion plantar të shtuar për shkak të neuropatisë motorike dhe me deformitet të pjesës së atakuar.(44) Lëkura e thatë e gatshme për të pranuar çfarëdo traume minimale është pasojë e komponentës autonome e cila shkakton anhidrozë dhe vazodilatim. Sipas sistemit klasifikues të Wagnerit simptomatologjia ndahet në disa shkallë:

Shkalla 0. Mungon plaga e hapur, prezente është vetëm skuqja

Shkalla 1. Ulceracion sipërfaqësorë

Shkalla 2.Plaga përfshin ligamentet,tendinat, kapsulat

Shkalla 3. Ulceracion i thellë me shenja të abscesit ose osteomielitit

Shkalla 4. Gangrena e gishtave ose e thembrës

Shkalla 5. Gangrena e shputës dhe fillestare e regjionit krural

Gjersa këto janë manifestime lokale(18) ,manifestimet e përgjithshme janë: rritja e temperaturës trupore, ethet, dridhjet, anoreksia, crregullimet hemodinamike (tahikardia, hipotensioni), leukocitoza, crregullimet metabolike (acidoza, crregullimet e pakontrolluara të glikemisë, vëllimi i zvogëluar dhe insuficienca e veshkëve). Zakonisht simptomatologjia sistemike është e pranishme te infeksionet e rënda që përfshijnë pjesë më të madhe të indeve me ndikimin e më shumë mikroorganizmave patogjen(19).

OSTEOMIELITI- Megjithëse shfaqet shpesh te shputa diabetike, vlerësimi dhe menaxhimi i tij ende janë të diskutueshëm. Infeksionet e indeve të buta jo të trajtuara në mënyrë të rregullt, marrin hov të zhvillimit edhe në inde më të thella e deri te kockat. Janë tre faktorë predispozues të cilët ndikojnë në ndryshimet në kocka. Së pari ndjesia e zvogëluar që lejon cfarëdo traume, qoftë mekanike apo edhe termike, deformitetet e shputës me crast ndryshon pika mbështetëse si dhe lëkura e thatë dhe e qarë si portë hyrëse për mikroorganizma,qofte bakteriale apo fungale. Fillimisht lokalizohet në pjesën periostale të kockës për të vazhduar më tutje. Diagnoza vendoset tek 2-3 javë pas atakimit të kockës kur edhe paraqiten imazhet e para radiologjike.



Pamje radiologjike e shputes diabetike

Strisho e kultures e marrë nga indet e buta përrreth ndryshimit të dyshimtë kockor **NUK** jep rezultat të njejtë me biopsinë e kockës së dyshimtë.(31). Trajtimi i ndryshimeve osteomielitike në kocka bëhet me kombinimin e metodës konzervative dhe kirurgjikale. Duke përdorur rezultatet e kulturave të kockave në qendra të ndryshme janë sajuar protokole të trajtimit që konsistojnë në dhënjen e terapisë së zgjatur me Fluorokinolone 4 deri në 6 muaj e kombinuar me metoda kirurgjike

minimale

ose

pa

kirurgji.



Në rastet e reseksionit të indit necrotik dhe kiretimit të indit kockor deri në ind të shëndoshë ordinohet terapia me antibiotikë 4 deri në 6 javë. Ndërsa në raste të reseksionit radikal të kockave dhe indeve të buta ordinohet terapia antibiotike më e shkurtër 1 deri në 2 javë.

EVALUIMI DIAGNOSTIK.- Bazë e evaluimit diagnostik është marrja e anamnezës me kujdes, ekzaminimi objektiv- posaqërisht inspekcioni. Është cekur edhe më heret që mjeku apo kirurgu me përvojë, në bazë të inspekcionit shpesh e identifikon edhe diabetin i cili qëndron në mënyrë tinzare, ende të padiagnostikuar. Historiku i sëmundjes është komponentë e rëndësishme për vlerësimin e rrezikut për shputë diabetike. Inspektimi i kujdesshëm duhet të bëhet gjithmonë pasi pacienti është shtrirë dhe ka hjekur këpucet dhe corapet. Inspektohet

së pari lëkura dhe atë ngjyra, thatësia , plasaritja, djersitja, infeksionet eventuale fungale, ulceracioni ose kallusi. Pastaj vërehen deformitetet e gishtave dhe të nyjeve.



Pozita e shpites gjate ekzaminimit

Neuropatia diabetike verifikohet shumë shpesh me përdorimin e testit me 10 gr monofilament, e që në shumë studime vleresohet si paraprirëse e ndryshimeve ulceroze (68,69). Ky lloj testimi është në përdorim në gjithë botën dhe efikasiteti i saj është konfirmuar në shumë studime dhe në Konferenca ndërkombëtare për Neuropatinë diabetike.

Për evaluim diagnostik është e domosdoshme marrja e strishos nga plaga e infektuar. Kultura duhet të merret pas pastrimit dhe debridmanit të plagës. Mostra është shumë më e saktë nëse mirret me

anë të kiretës apo edhe bisturisë se ajo e cila mirret me anë të shtupës së thjeshtë. Shtupat e zakonshme mund të kontaminohen me florë normale të lëkurës, e poashtu edhe më rrallë izolohehen bakteriet anaerobe për arsye të shkatërrimit të tyre në rast kontakti me O₂. (20). Poashtu metoda të pranueshme janë edhe aspirimi i sekrcionit purulent nga indet si dhe biopsia e indeve të buta ose edhe punkcion biopsia e kockave të dyshimta për osteomielit. Kultura e strishos nuk korespondon me kulturën e kockave ashtu që në rast të dyshimit në osteomielit nuk duhet të udhëhiqemi nga strisho e marrë nga plaga dhe nga indet e buta.

Për sa i përket edhe ekzaminimeve të tjera diagnostikuese gjithsesi është i nevojshëm imazhi rentgenologjik i shputës, edhe pse ndryshimet në kocka në fazën e parë mund të mos vërehen 2 deri në tre javët e para. Sipas modaliteteve të imazhit MRI jep të dhëna rreth 80-90% të sakta dhe për tani është procedurë e zgjedhjes për zbulimin e hershëm të osteomieliteve dhe anomalive të indeve të buta. Fatkeqësisht për shkak se është metodë mjaft e shtrenjtë të ne nuk përdoret.

Vlerësimi i qarkullimit të gjakut në sistemin arterial të ekstremiteteve të poshtme është moment kyq në procedimin e mëtutjeshëm të planit terapeutik(45). Pamjaftueshmëria e qarkullimit në sistemin arterial ndikon në përgjegjen e dobët imunologjike të organizmit si dhe në

shpërndarjen e dobët të antibiotikëve në indet e dëmtuara. Nuk ka ndonjë testim për evaluim të posaqëm të crregullimeve vaskulare në personat me shenja për shputë diabetike. Kirurgu me pervojë te rastet më të shpeshta nuk ka problem diagnostikimi. Mungesa e pulsacioneve periferike në arterien tibialis posterior dhe ne arterien dorsalis pedis sinjalizojnë për crregullime vaskulare me crast duhet të vazhdohet me metoda të tjera diagnostikuese siq janë Echo doppleri i sistemit arterial, aortoangjiografia me kontrast, CT ose/dhe MRI angjiografia që janë të mjaftueshme për prezantimin komplet të sistemit arterial, me cka sygjerohet ecuria e mëtutjeshme/rekonstrukcioni vaskular apo vetëm terapia konzervative (12).

PARANDALIMI DHE TRAJTIMI I SEMUNDJES.- Themelet per mbrojtjen dhe përkujdesjen e të sëmurëve me diabet janë vendosur në konferencën ndërkombëtare për diabet të mbajtur në St Vinscent, me 10-12 tetor 1989. Përfaqësuesit e departamenteve shëndetësore qeveritare dhe organizatat e pacientëve diabetik nga të gjitha vendet e Evropës u takuan me ekspertët e diabetit nën kujdesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe Federatës Ndërkombëtare per Diabet ne Evrope(IDF). Qëllimet u standardizuan si një grup i planeve për përmirësimin e kujdesit ndaj pacientëve. Përveq tjerash në Deklaratë kërkohet nga shërbimet shëndetësore qeveritare të shteteve

të bëjnë njohjen formale të problemit të Diabetit dhe të vendosë në dispozicion burimet për planifikim të prevenimit, identifikimit dhe trajtimit të sëmundjes e në veqanti komplikimeve të saj, me theks të posaqëm në gangrenen e shputës dhe amputimin si pasojë. Sot, më se 20 vjet prej kësaj Deklarate, fatkeqësisht në vendin tonë ende nuk ka ndonjë organizim të mirëfillët për implementimin e standardeve.(70,71)

Bazë e trajtimit mjekesor është terapia antimikrobike me antibiotik specifik të cilët ordinohe sipas antibiogramit. Kjo terapi shkon gjithmonë e kombinuar me përpunim të plagës, toaletë të shpeshtë, debridman apo largim kirurgjik të masave nekrotike dhe fibrinës dmth me ekscizion të plotë deri në ind të shëndoshë(50). Për infeksionet të cilat zhvillohen në thellësi dhe është prezente sasia e gazit , abscesi apo edhe shenjat e fasciitit necrotizues rekomandohet intervenimi kirurgjik urgjent me principe të incizioneve sa më të thella dhe më të gjata deri në fasciotomi dhe largim komplet të masave nekrotike me qëllim të parandalimit të zhvillimit të hovshëm të bakterieve anaerobe.



Faza te ndryshme te perpunimit te plageve te shputa diabetike

Te pacientët me insuficiencë vasculare bëhet rekonstrukcioni i enëve të gjakut, mvarësisht nga rezultatet e diagnostikimit. Procedurat më të shpeshta janë krijimi i urëzimeve dhe tejkalimi i pjesës së mbyllur të

enës së gjakut me venë ose në pamundësi të përdorimit të venës autologe, me protezë sintetike. Metodat e kirurgjisë endovaskulare kanë treguar rezultate më të kënaqshme për trajtimin e pacientëve me insuficiencë vaskulare arteriale.

Trajtimi me metoda përcjellëse sic është komora (dhoma) hiperbarike nuk ka treguar rezultate në të gjitha rastet. Poashtu kostoja e lartë e kësaj metode ka bërë që të mos përdoret si terapi fillestare por të përdoret te pacientët të cilët nuk i janë përgjigjur asnjë lloji tjetër të trajtimit. Varësisht prej dëmtimit të indeve të buta dhe kockave dhe potencialit të tyre për përhapje të mëtejshme, bëhet edhe amputimi i gishtave ose edhe i ekstremitetit në nivel të nevojshëm.

AMPUTIMET.- Amputimi është procedurë kirurgjike që performohet për shkak të indikacioneve të caktuara në pacientët diabetik. Indikacionet multiple përfshijnë ulcercionet e pashërueshme, deformitetet e shputës dhe osteomielitin, gangrenën e shputës, mbylljen e enëve periferike të gjakut si dhe intoksikimin e organizmit për shkak të infeksionit.(39). Të gjitha këto janë të shoqëruara edhe me disa gjendje të përgjithshme të prekura të organizmit për shkak të hipertensionit arterial të rritur, hiperholesterolemisë, tymosjes së duhanit, imunitetit të zvogëluar rrisin shkallën e rrezikut për amputim.(41)

QELLIMI I PUNIMIT

Nisur nga fakti se shputa diabetike paraqet problem të madh medicinal, social, ekonomik, personal dhe shoqëror punimi ka për qëllim të japë

përgjigje në disa çështje. Por, duhet pasë parasysh edhe paraqitjen e pacientëve te ne në stadi relativisht të vonuara prandaj nuk kemi pasë mundësi të studiojmë efektin parandalues, por vetëm shkaqet ose faktorët e rrezikut të mbledhura në mënyrë retrospektive me anë të anamnezës, si dhe trajtimin e tyre pas hospitalizimit. Çështjet më me interes janë:

- analiza e rasteve të shputës diabetike të regjistruara në repartin e Kirurgjisë Vaskulare të QKUK gjatë vitit 2013, të prezantuara sipas demografisë.
- vlerësimi i rëndësisë së diagnostikimit të drejtë
- mënyra e trajtimit dhe e komplikimeve
- mundësia e parandalimit të amputimeve, posaqërisht atyre madhore me ndërmarrjen e masave siq janë eliminimi i faktorit infektues me anë të ordinimit të antibiotikëve e toaletës dhe/ose faktorit Vaskular me anë të rekonstrukcionit kirurgjik në enë të gjakut në ekstremitet të poshtme.
- sensibilizimi i pacientëve që të jenë të rregullt në kontrollimin e glikemisë, marrjen e terapisë dhe konsultave të shpeshta me personelin shendetësor gjegjës.

- sensibilizimi i mjekëve dhe tërë personelit shendetësor të jenë më vigjilent ndaj cdo shenje klinike e cila mund te pasojë me sëmundje, komplikim të saj deri në vdekje.

MATERIALI DHE METODAT

Hulumtimi është përcaktuar si hulumtim epidemiologjik dhe i takon grupit të hulumtimeve observuese të serisë së rasteve me shputë diabetike, të trajtuar në QKUK në vitin 2013. Është bërë trajtim i zgjeruar i një problematike shumë komplekse.

Kemi shfrytëzuar të dhëna burimore të dorës së parë. Mostrën e kanë përbërë të gjitha rastet e hospitalizuara. Janë analizuar 234 pacientë. Moshë mesatare ka qenë 30-80 vjeq, me shputë diabetike në stadi të ndryshme të zhvillimit. Mostra e analizuar ka qenë reprezentative dhe me madhësi adekuate për testim me precizitet të duhur statistikor. Për grupimin dhe klasifikimin e të sëmurëve kemi përdorë kritere të qarta selektimi, të përshtatshme dhe shkencërisht të pranueshme. Problemi shkencor është formuluar ashtu që synojmë të analizojmë epidemiologjinë e shputës diabetike, etiologjinë, rëndësinë e zbulimit dhe marrjen e masave preventive për identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe trajtimin e saj me qëllim të komplikimeve sa më të rralla e njëherit edhe eliminimin e amputimeve madhore si pasojë e sëmundjes.

Janë analizuar: tipi i diabetit, statusi lokal, statusi vaskular, sëmundjet përcjellëse, analizat bakteriologjike, ditët e hospitalizimit, lloji i trajtimit si dhe intervenimet kirurgjike të realizuara qoftë vetëm lokale apo edhe rekonstruktive vaskulare.

Si burim të dhënash kanë shërbyer historitë e sëmundjes ku te çdo pacient është marrë anamneza, fillimi i shenjave të para të sëmundjes, lokalizimi i plagës, lloji i plagës (gangrenë e thatë apo e njomë), buzët e plagës (të rregullta apo të çrregullta), senzacionet nervore në shputë, ekzaminimi joinvaziv i pulseve në arteriet periferike, Echo doppleri i sistemit arterial e në raste të nevojshme edhe metodat invazive si CT angiografia dhe MRI aniografia. Janë bërë analizat rutinore laboratorike (hemogrami, urina, urea, kreatinina, SE, glikemia), është bërë RTG e shputës për të parë ndryshimet eventuale në kockë. Nga dita e parë është filluar terapia me antibiotikë standard, me vazodilatatorë dhe me antiagregues. Debridmenti ekstenziv i plagës është bërë qoftë me anestezion lokal apo të përgjithshëm. Gati te të gjithë pacientët është marrur strishoja nga plaga dhe në bazë të antibiogramit janë ordinuar antibiotikët lokal në plagë apo parenteral. Sipas nevojës janë realizuar intervenime komplekse vaskulare me qëllim të revaskularizimit siq janë urëzimet apo Bypass në nivele të nevojshme(52). Largimi i indeve të dëmtuara është bërë në formë të nekrektomisë, amputimit të gishtave, amputimit në nivel tarsometatarsal, crural deri te amputimi femoral.


Të dhënat janë analizuar me SPSS program dhe janë njehsuar parametrat e nevojshëm statistikore si dhe rezultatet janë prezantuar me tabela dhe grafikone përkatëse kurse janë testuar për nivelin 95% ($P < 0.05$) të besueshmërisë dhe 99.7% ($P < 0.001$).

REZULTATET

Prej të gjitha patologjive të udhëzuara (6920) për konsultime specialistike 54.2% i takojnë shputave diabetike që paraqet një problem mjaft madhor në mesin e të gjitha patologjive të sistemit vaskular (**tabela 1, grafikoni 1**).

Tabela 1. Struktura e patologjive të shputës diabetike dhe atyre vaskulare në mesin e të gjitha ekzaminimeve specialistike


Patologjitë	N	Prevalenca (%)
Patologji të shputës	3750	54.19
Patologjitë tjera vaskulare	3170	45.81
Gjithsej - Egzaminime specialistike	6920	100.0



Nga të gjitha ndërhyrjet kirurgjikale të cilat janë realizuar në repartin tonë gjatë vitit 2013, shputa diabetike ka qenë prezente në 25.4% të rasteve e që paraqet një patologji shumë të shpeshtë (**tabela 2**). Të gjitha këto intervenime janë kryer në sallën operative të kirurgjisë Vaskulare në anestezion lokal, të shkurtër intravenoz, spinal dhe anestezion të përgjithshëm.

Tabela 2. Prevalenca e ndërhyrjeve të shputës diabetike në mesin e të gjitha ndërhyrjeve kirurgjikale në kirurgjinë vaskulare për vitin 2013


Llojet e ndërhyrjeve kirurgjike	N	%
Intervenime të ndryshme vaskulare	622	67.6
Shputë diabetike	234	25.4
Gjithsej te hospitalizuar	920	100.0



Gjithsej për periudhën 2013 me shputë diabetike janë trajtuar 234 pacientë, sëmundja më tepër paraqitet te meshkujt krahasuar me femrat me dallim të rëndësishëm statistikorë për $P < 0.0001$, dhe atë nga gjithsej 234 pacientë 76.1% e tyre janë meshkuj (**tabela3**),

Tabela 3. Struktura e pacientëve me shputë diabetike sipas gjinisë të trajtuar për vitin 2013

Gjinia	N	%	X^2 -testi
Femra	56	23.9	$X^2=63.6$; SHL=1; $P < 0.00001$
Meshkuj	178	76.1	
Totali	234	100.0	-





Grup moshë më e prekur nga problemet e shputës diabetike kanë qenë mbi moshën 50 vjet dhe atë pjesa më e madhe e pacientëve të trajtuar

ishin të grup moshës 65-74 vjet, moshë mesatare e të trajtuarve ka qenë 63.4 vjet, për meshkuj 63.3 dhe për femra 63.7 vjet, pa dallim sipas gjinisë $P>0.05$. **(tabela 4)**

Tabela 4. Struktura e pacientëve sipas grup moshave dhe gjinisë

Grup moshë	Gjinia				Gjithsej		X ² -testi
	Femra		Meshkuj				
	N	%	N	%	N	%	
30-44	4	7.1	4	2.2	8	3.4	X ² =7.67; SHL=4; P>0.05
45-54	8	14.3	30	16.9	38	16.2	
55-64	12	21.4	63	35.4	75	32.1	
65-74	26	46.4	60	33.7	86	36.8	
75+	6	10.7	21	11.8	27	11.5	
Totali	56	100.0	178	100.0	234	100.0	-
Moshë mesatare	63.7 vjet		63.3 vjet		63.4 vjet		





Në **tabelën 5** janë prezentuar rastet e analizuara sipas trajtimit të diabetit me apo pa insulinë, nga të dhënat e analizuara rezulton se


shumica e pacientëve janë insulin varës dhe atë 164 apo 70.1% me dallim sinjifikant për $P < 0.0001$ dhe atë të të dy gjinitë (tabela 2, grafikoni 4). Vlenë të ceket se edhe te moshat e reja, me një përqindje të lartë, janë pacientët të varur nga insulina.

Tabela 5. Pacientët sipas tipit të diabetit dhe gjinisë

Tipi I diabetit	Gjinia				Gjithsej	
	Femra		Meshkuj			
	N	%	N	%	N	%
Me insuline	36	64.3	128	71.9	164	70.1
Pa insuline	20	35.7	50	28.1	70	29.9
Totali	56	100.0	178	100.0	234	100.0
X^2 -testi	$X^2=0.84$; SHL=1; $P>0.05$				$X^2=37.76$; SHL=1; $P<0.00001$	




Grafikoni 5b. Rastet sipas tipit të diabetit dhe grup moshave



Në **tabelën 6** janë analizuar shkaktarët të cilët (sipas anamnezës) i kanë parapri ndryshimeve serioze në shputë. Sipas tabelës rezulton se ndryshimet te numri më i madh i pacientëve 38.9% kanë filluar pahetueshëm. Në këtë term kemi përfshirë të gjitha **ulceracionet** në shputë të cilat janë paraqitur në stad të ndryshëm të zhvillimit. Osteomieliti,poashtu është faktor i shpeshtë që sjell pacientin në hospitalizim dhe intervenim kirurgjik. Djegja ka qenë shkaktar në 15.8% të rasteve dhe atë në stinën e dimrit për shkak të neuropatisë së shprehur dhe nevojës së pacientëve për ti ngrohur këmbët.

